



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE  
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR  
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Pursuant to instruction of the Pre-Trial Judge contained in KSC-BC-2020-04/CRSPD5 of 29 April 2021, reclassified as PUBLIC.

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Për:** Gjykatësin e Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 31 mars 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

---

**Parashtrim i versionit me më pak redaktime dhe versionit të redaktuar publik të  
Aktakuzës së konfirmuar dhe i kërkesave lidhur me to  
me shtojcat 1-2 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte***

---

**Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

Pursuant to instruction of the Pre-Trial Judge contained in KSC-BC-2020-04/CRSPD5 of 29 April 2021, reclassified as PUBLIC.

1. Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') dorëzon për protokollim si vijon:
  - (i) një version rreptësisht konfidencial me më pak redaktime të Aktakuzës së konfirmuar, për t'iu dorëzuar të akuzuarit pas transferimit të tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë;<sup>1</sup> dhe
  - (ii) në bazë të rregullës 82(2) të Rregullores<sup>2</sup> dhe në përputhje me vendimin e konfirmimit,<sup>3</sup> një Aktakuzë të redaktuar publike.<sup>4</sup>
2. ZPS-ja kërkon që Aktakuza e redaktuar publike të riklasifikohet si publike pas konfirmimit të transferimit të të akuzuarit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë.
3. Gjithashtu, ZPS-ja nuk ka kundërshtim që fletarrestimi<sup>5</sup> dhe urdhri për transferim<sup>6</sup> të riklasifikohen si publikë pas konfirmimit të transferimit të të akuzuarit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, me kusht që të redaktohet informacioni i mëposhtëm, në përputhje me redaktimet e zbatuara në Aktakuzën e redaktuar publike:
  - a. të dhënat personale të të akuzuarit (d.m.th. shtetësia, numri i shtetësisë, adresa);<sup>7</sup> dhe
  - b. numri i të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës.<sup>8</sup>

<sup>1</sup> Shtojca 1. Ky version i Aktakuzës së konfirmuar nuk përmban disa nga redaktimet që gjenden në versionin rreptësisht konfidencial të redaktuar të Aktakuzës së konfirmuar, parashtruar më 19 qershor 2020, në përputhje me vendimin e konfirmimit (Vendim mbi konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës, KSC-BC-2020-04/F00007, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Vendimi i konfirmimit').

<sup>2</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Përveç nëse specifikohet ndryshe, çdo referencë për "rregulla/rregullat" i referohet Rregullores.

<sup>3</sup> Vendimi i konfirmimit, KSC-BC-2020-04/F00007, para. 18.

<sup>4</sup> Shtojca 2.

<sup>5</sup> Fletarrestim për z. Pjetër SHALA, KSC-BC-2020-04/F00008/A01, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Fletarrestimi').

<sup>6</sup> Urdhër për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-04/F00008/A02, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Urdhri për transferim').

<sup>7</sup> Fletarrestimi, KSC-BC-2020-04/F00008/A01, p.1; Urdhri për transferim, KSC-BC-2020-04/F00008/A02, f.1.

<sup>8</sup> Fletarrestimi, KSC-BC-2020-04/F00008/A01, f.2, para. 2.

Pursuant to instruction of the Pre-Trial Judge contained in KSC-BC-2020-04/CRSPD5 of 29 April 2021, reclassified as PUBLIC.

4. Ky parashtrim dhe shtojcat e tij dorëzohen për protokollim si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, në përputhje me rregullën 82(4).

**Numri i fjalëve (në origjinal): 321**

\_\_\_\_\_  
/nënshkrimi/

**Xhek Smith**  
**Prokuror i Specializuar**

E mërkurë, 31 mars 2021  
Në Hagë, Holandë.